



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRIZREN

Numri i lëndës: 2023:260997

Datë: 21.08.2024

Numri i dokumentit: 06070858

C.nr.4438/23

GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN-Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Civil, gjyqtari Shyqri Hoxha, me praktikanten gjyqësore V.G. në çështjen juridike kontestimore të paditëses R.I. me numër personal nga Prizreni, të cilën sipas autorizimit e përfaqëson v. A.H. nga Prishtina, kundër të paditurës Komuna e Prizrenit-Drejtoria Komunale e Arsimit, me objekt kontesti kompensimin e inflacionit në pagë, vlera e kontestit 288.70 euro, me datë 21.08.2024 mori këtë:

A K T G J Y K I M

(Pa shqyrtim kryesor të çështjes)

- I. **APROVOHET PJESËRISHT** si e bazuar kërkesëpadia e paditëses R.I. nga Prizreni. **DETYROHET** e paditura Komuna e Prizrenit-Drejtoria Komunale e Arsimit, që paditëses, në emër të pagesës së inflacionit në pagë nga data 01.07.2022 deri më 20.11.2022, t'ia kompensoj shumën e përgjithshme prej **248.36 euro**, me kamatë ligjore prej 8%, nga dita e parashtrimit të padisë me datë 15.11.2023, e deri në pagesën definitive, të gjitha këto në afat prej 7 ditësh, pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nën kërcënim të përmbarimit të detyrueshëm.
- II. **REFUZOHET e pa bazuar** pjesa tjetër e kërkesëpadisë së paditëses, përtej shumës së gjykuar sikur në pikën I. të dispozitivit të aktgjykimit deri në shumën e kërkuar prej 288.70 euro, përkatësisht shuma prej 40.34 euro, në emër të pagesës mbi bazën e përqindjes së inflacionit
- III. **DETYROHET** e paditura, që paditëses t'ia kompensoj shpenzimet e procedurës kontestimore në shumën prej **124.00 euro**, në afat prej 7 ditësh pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nën kërcënimin e përmbarimit të detyrueshëm.

Ar sy e t i m

Paditësja R.I. nga Prizreni, përmes të autorizuarit të saj Av.A.H. nga Prishtina, pranë kësaj gjykate me datë 15.11.2023, ka parashtruar padi kundër të paditurës Komuna e Prizrenit-Drejtoria Komunale e Arsimit, me objekt kontesti kompensimin e inflacionit në pagë, në referatin e padisë ka theksuar se paditësi është në marrëdhënie pune në SH.M.L. "Gjon Buzuku" në Prizren, mësimdhënëse dhe atë me kontratë pune në kohë të pacaktuar, bazuar në nenin 35 par.10 të Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë, është paraparë që për çdo vit të përcillet shkalla e inflacionit sipas Entit të Statistikave të Republikës së Kosovës dhe përqindja e inflacionit të futet në pagë, mirëpo e paditura këtë kompensim nuk i ka paguar paditësit deri më tani. Ka theksuar se në vitin 2022 mesatarja e inflacionit në vend ka qenë 11.6%. Po ashtu, ka theksuar se edhe pas kërkesës së vazhdueshme për këto kompensime pranë të paditurës, deri më tani nuk ka marrë përgjigje. Pasi që e paditura nuk e ka përmbushur kërkesën e paditësit vullnetarisht, gjykatës i ka propozuar që të merr aktgjykim dhe ta aprovojë kërkesëpadinë në tërësi si të bazuar. Shpenzimet e procedurës kontestimore i ka kërkuar.

E paditura Komuna e Prizrenit - Drejtoria Komunale e Arsimit, përmes të autorizuarit të saj, në këtë gjykatë ka paraqitur përgjigje në padi, ku ka theksuar se e kundërshton në tërësi padinë dhe kërkesëpadinë e paditësit si të pa bazuar. Pretendimet e paditësit se i takon kompensimi i inflacionit është në kundërshtim me nenin 2 paragrafi 1.1 të Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë, sepse në këtë dispozitë shkruan qartë se përfitues të të gjitha beneficioneve që rrjedhin nga Kontrata Kolektive e Arsimit janë vetëm anëtarët e Sindikatës së Arsimit-SBASHK-ut. Paditësi ushtron padi në gjykatë për realizimin e të drejtave të tyre pa përfunduar procedura administrative, sepse nuk i ka vazhduar procedurat në Inspektoratin e Punës në Prizren. Padia është në kundërshtim të plotë me nenin 56 të Ligjit të Punës, sepse me këtë dispozitë parashihet decidivisht se çka përfshinë paga shtesë. Andaj çështja e pagës shtesë për shkak të inflacionit siç pretendojnë paditësit nuk lejohet me ligjin e punës, i cili ligj në këtë rast është ligj i veçantë dhe e rregullon çështjen e pagës shtesë dhe rrjedhimisht ligji i veçantë në çdo çështje ka epërsi kundrejt çdo ligji apo akti nënligjor. Pretendimet e paditësit se i takon beneficioni nga Kontrata Kolektive e Arsimit në Kosovë, janë në kundërshtim me nenin 90 paragrafët 1.1 dhe 1.2 të Ligjit të Punës të R. Kosovës Nr.03/L-212, sepse sipas këtyre dispozitave marrëveshja kolektive lidhet në mes të organizatës së punëdhënësve dhe organizatës së të punësuarve, ndërsa në këtë rast Komuna e Prizrenit është punëdhënësi dhe nuk mund të obligohet në përmbushjen e kësaj kontrate, pa qenë palë nënshkruese e kësaj kontrate. Po ashtu ka theksuar se në bazë të njoftimit të Ministrisë së Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit nr.01B/ të datës 21.11.2022, për shkëputjen e Kontratës Kolektive të Arsimit të datës 22.01.2021 padia dhe kërkesëpadia e paditësit është e pa bazuar. Në fund gjykatës i ka propozuar që padinë dhe kërkesëpadinë e paditësit ta refuzoj në tërësi si të pabazuar. Shpenzimet e procedurës kontestimore nuk i ka kërkuar.

Gjykata pas shqyrtimit të padisë, provave që gjenden në shkresat e lëndës, si dhe përgjigjes në padi të paraqitur nga ana e të paditurës, në kuptim të nenit 8 lidhur me nenin 152 të LPK, gjeti se kërkesëpadia e paditëses është e themeltë, andaj pa caktuar seancë gjyqësore, vendosi lidhur me kërkesëpadinë si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Nga parashtrimet e palëve ndërgjyqëse të paraqitura me padi dhe përgjigjes në padi, gjykata ka gjetur se nga Kontrata e Punës me numër të protokollit 1119, e datës 15.10.2015, për paditësin e lëshuar nga Komuna e Prizrenit - Drejtoria e Arsimit, këtu e paditura, në versionin e fotokopjuar, vërtetohet fakti se paditësi është në marrëdhënie pune tek e paditura, në Gjimnazin "Gjon Buzuku" në Prizren, si mësimdhënës. Bazuar në Listën e pagave të lëshuar nga Buxheti i Republikës së Kosovës vërtetohet lartësia e pagës bazë të paditësit e që është shuma prej 459.00 euro. Po ashtu gjykata bazuar në Indeksën e Harmonizuar të Çmimeve të Konsumit sipas Entit të Statistikave të Republikës së Kosovës ka vërtetuar se shkalla e inflacionit për vitin 2022 ka qenë 11.6%. Gjykata provave të lartcekura iu fali besimin e plotë ngase është bërë e besueshme fuqia provuese e tyre, duke u bazuar edhe në nenin 329 par.1 të LPK-së, i cili përcakton se *"Shkresa të cilën e ka hartuar në formën e caktuar organi shtetëror brenda kufijve të kompetencës së vet, si dhe shkresa të cilën në formë të tillë e ka hartuar ndërmarrja apo organizata tjetër në ushtrimin e autorizimeve publike që i janë besuar me ligj (dokumenti publik), provon saktësinë e asaj që konfirmohet apo caktohet në të"*.

Gjykata gjen se në rastin në fjalë duhet të zbatohen dispozitat e Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë (KKAK), të nënshkruar në mes të Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë dhe Sindikatës së Bashkuar të Arsimit, Shkencës dhe Kulturës, e cila ka hyrë në fuqi me datë 22.01.2021, ku në nenin 35 par.10 parashihet se *"Për çdo vit të përcillet shkalla e inflacionit sipas Entit të Statistikave të Republikës së Kosovës dhe përqindja (%) e inflacionit të futet në pagë"*, si dhe duke u bazuar edhe në mendimin juridik të gjykatës Supreme të Kosovës nr.214/2023 date 09.10.2023 ku në pikën II parashihet që *"Punëtorët në bazë të Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë të datës 18.04.2017, dhe Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë të datës 22.01.2021, kanë të drejtë që në pagën e tyre të futet përqindja e inflacionit marrë për bazë shkallën e inflacionit çdo vit, sipas Entit të Statistikave të Republikës së Kosovës, ashtu siç është përcaktuar me nenin 35, pika 10 të këtyre marrëveshjeve"* ashtu që gjykata erdhi në përfundim se në rastin konkret paditësit i takon e drejta në pagesën mbi bazën e përqindjes së inflacionit, si në pikën I të dispozitivit të këtij aktgjykimi dhe atë sipas përlllogaritjes së bërë në këtë mënyrë:

- Për periudhën 01 Korrik 2022 - 20 Nëntor 2022, gjykata pati parasysh që shkalla e inflacionit ka qenë 11.6%, ashtu që duke pasur parasysh se paga bazë e paditësit ka qenë 459.00 euro, i bie që përqindja e inflacionit që është dashur të futej në pagë është 212.96 euro ($459.00 \times 11.6\% = 53.24 \times 4 \text{ muaj} = 212.96$), si dhe për 20 ditë të muajit nëntor ($53.24 \div 30 = 1.77 \times 20 \text{ ditë} = 35.4$ euro) apo në shumën e përgjithshme prej 248.36 euro.

Gjykata me rastin e vendosjes jashtë seancës gjyqësore, është bazuar në nenin 152 të LPK-së, ku parashihet që *“po që se i padituri me anë të përgjigjes në padi i ka pohuar faktet vendimtare, përkundrejt kontestimit të kërkesëpadiës, gjykata mundet pa caktuar seance gjyqësore, të jep aktgjykim (neni 143 dhe 147 të këtij ligji), nëse nuk ekzistojnë pengesa të tjera për dhënien e tij”*. , andaj ka vendosur si në pikën nën I të dispozitivit të këtij aktgjykimi.

Gjykata vendosi sikurse në dispozitiv të këtij aktgjykimi duke aprovuar shumën përkatëse dhe duke llogaritur kamatën ligjore si në dispozitiv, bazuar në nenin 382 par. 1 dhe 2 të LMD-së, duke e llogaritur të njëjtën nga dita e parashtrimit të padisë në këtë gjykatë (15.11.2023), bazuar në Mendimin Juridik për Kamatën të Gjykatës Supreme të Kosovës nr. 265/2020 të datës 02.12.2020, pasi që në rastin konkret pala e paditur është vonuar në përmbushjen e obligimit ndaj palës paditëse.

Ndërsa sa i përket pjesës refuzuese, gjykata vendosi jashtë seancës gjyqësore edhe atë në kuptim të nenit 399 paragrafi 1 të LPK-së, ku parashihet që *“Kur gjykata, pasi t'i arrijë përgjigja në padi, konstaton se nga faktet e treguara në padi nuk del themelësia e kërkesëpadiës, atëherë ajo do të jep vendimin meritore me të cilin refuzohet si e pathemeltë kërkesëpadija”*, Duke marrë për bazë se gjykata në kuptim të nenit 2.1 të LPK-së vendos brenda kërkesës së palëve ndërgjyqëse dhe se paditësi ka kërkuar që kompensimi në emër të inflacionit të realizohet në bazë të pagës neto prej 534.08 euro, mbi këtë bazë gjykata morri për bazë lartësinë e pagës bazë prej 459.00 euro. Andaj, mbi këtë bazë gjykata aprovoi pjesërisht kërkesëpadiinë e paditësit sikurse në pikën nën I të dispozitivit të aktgjykimit, ndërsa pjesën tjetër e refuzoi të pabazuar sikurse në pikën nën II të dispozitivit të aktgjykimit.

Sa i përket kundërshtimeve të paditurës me përgjigje në padi, Gjykata vlerëson se të njëjtat nuk janë të bazuara mbi dispozitat ligjore dhe nuk mbështeten në ndonjë bazë faktike apo juridike. Rrjedhimisht, gjykata erdhi në përfundim se faktet nuk ishin kontestuese dhe nuk ekzistojnë pengesa për dhënien e vendimit meritore.

Gjykata ka vlerësuar edhe provat tjera materiale të cilat gjinden në shkresat e lëndës, por ka ardhur në përfundim se të njëjtat janë pa ndikim në nxjerrjen e këtij aktgjykimi.

Vendimin që pala e paditur t'i bartë shpenzimet e procedurës, gjykata e ka mbështetur në dispozitat e nenit 449, 452 dhe 453.2 të LPK-së, sipas Tarifës së Odës së Avokatëve, lartësia e shpenzimeve i referohet përpilimit të padisë në shumën prej 104.00 euro dhe taksës gjyqësore në shumën prej 20.00 euro, përkatësisht shumën e përgjithshme prej 124.00 euro.

Duke u bazuar në të dhënat e lartcekura, gjykata ka vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi në pajtim me dispozitat e nenit 398 dhe nenit 399 të LPK-së.

GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN
DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM-DIVIZIONI CIVIL
C.nr.4438/2023, datë 21.08.2024

G j y q t a r i

Shyqri Hoxha

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi palët kanë të drejtë ankese në afat prej shtatë (7) ditëve nga dita e pranimit pranë Gjykatës së Apelit, përmes kësaj Gjykate. Ankesa duhet të paraqitet në kopje të mjaftueshme për palët dhe gjykatën.